



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

Nr. Prot. 6340 datë 15.11.2022

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. Prot. 11896 datë 15.11.2022

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. Prot. 1547 datë 15.11.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**“Për ruajtjen e përkohshme të objekteve të sekuestruara pjesë e trashëgimisë
kulturore”**

- TË VETËDIJSHËM:** Për nevojën dhe frymën e bashkëpunimit të gjërë në ndërmarjen e veprimeve që lidhen me ruajtjen e specializuar të objekteve të dyshuara si objekte të trashëgimisë kulturore;
- ME SYNIM:** Rritjen e angazhimeve dhe kapaciteteve institucionale e profesionale, si dhe rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional për parandalimin e dëmtimit dhe ruajtjen e specializuar të objekteve të dyshuara si objekte të trashëgimisë kulturore.
- NË MBËSHTETJE TË:**
- Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 102 pika 4 dhe 148/b shkronja “dh”;
 - Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
 - Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
 - Ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
 - Ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;

ME PALË NËNSHKRUESE:

Ministria e Kulturës (në vijim: MK), e përfaqësuar nga **Ministri i Kulturës**;

Ministria e Brendshme (në vijim: MB) e përfaqësuar nga **Ministri i Brendshëm**;

Prokuroria e Përgjithshme (në vijim: PP), dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të përfaqësuar nga **Prokurori i Përgjithshëm**;

të cilat

bien dakord për Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë:

Neni 1
Objekti

1. Kjo marrëveshje përcakton mënyrat e bashkëpunimit brenda kompetencave ligjore të Palëve për gjurmimin, kapjen, sekuestrimin, magazinimin dhe ruajtjen e specializuar të objekteve të dyshuara “pasuri kulturore”, nga momenti i sekuestrimit të tyre e deri në përfundim të hetimeve paraprake dhe/ose gjykimit me vendim të formës së prerë sipas ligjit.

2. Gjithashtu, marrëveshja përcakton masat mbikëqyrëse dhe koordinuese të nevojshme sipas fazave të procedimit dhe kompetencave ligjore, për shkëmbimin e informacioneve dhe për magazinimin dhe ruajtjen e objekteve të dyshuara trashëgimi kulturore të sekuestruara.

Neni 2

Fusha e veprimit

Në kuadrin e kësaj Marrëveshje Palët përkatëse koordinojnë dhe monitorojnë bashkëpunimin e institucioneve dhe agjensive/strukturave përkatëse të zbatimit ligjit, në gjurmimin, kapjen, sekuestrimin, magazinimin dhe ruajtjen e specializuar të objekteve pasuri trashëgimi kulturore dhe/ose konfiskimin e tyre, të dyshuara të vjedhura ose trafikuar, të kryera nga subjekte person fizik dhe/ose person juridik.

Neni 3

Angazhime të Ministrisë së Kulturës

1. Ministria e Kulturës, nëpërmjet Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), me marrjen e njoftimit dhe të vendimit të ekspertimit nga organi procedues, ndjek dhe realizon veprimet si më poshtë:

- a) kryen ekspertimin/vlerësimin dhe klasifikimin e objekteve të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore, si dhe harton aktin/raportin përkatës sipas ligjit;
- b) angazhohet për të bërë të mundur lëvizjen e objekteve, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës të administruar nga IKRTK-ja;
- c) asiston gjatë inventarizimit nga IKRTK dhe ofron ekspertizën e specializuar.

2. IKRTK, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Kulturës, administron (magazinin dhe ruan) objektet e dyshuara trashëgimi kulturore të sekuestruara në ambiente të krijuara dhe të dedikuara posaçërisht për këtë qëllim.

Neni 4

Angazhime të Ministrisë së Brendshme

1. Ministria e Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit:

- a) kontrollon, administron, ndjek dhe menaxhon gjithë informacionin policor nëpërmjet sistemit MEMEX për vjedhjen ose trafikimin e objekteve të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore;
- b) merr të gjitha masat për të siguruar shoqërimin fizik të objekteve të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore drejt pikës së magazinimit dhe ruajtjes nga IKRTK;
- c) dërgon për ekspertim/vlerësim e klasifikim në IKRTK objekte të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore dhe kopje të aktit të ekspertimit/vlerësimit administrohen në dispozicion të fashikullit të hetimeve.

2. Në rast se Policia e Shtetit gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj konstaton objekte “pasuri kulturore”/të dyshuara “pasuri kulturore”, të vjedhura ose të trafikuar njofton menjëherë

Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si dhe mund të marrë përsipër magazinimin e përkohshëm të këtyre objekteve.

Neni 5

Angazhime të Prokurorisë së Përgjithshme

1. Prokuroria e Përgjithshme angazhohet të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm për rritjen e efijencës në hetimin dhe ndjekjen penale të vjedhjes dhe trafikimit të objekteve të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore dhe mënyrën e administrimit të tyre.
2. Në ndjekjen e rasteve/çështjeve për veprat penale të vjedhjes dhe/ose trafikimit të pasurive trashëgimi kulturore, prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione me institucionet e përfshira në këtë Marrëveshje, si dhe pasuritë e dyshuara trashëgimi kulturore në cilësinë e provave materiale i dërgohen për ekspertim/vlerësim, klasifikim dhe për administrim/ruajtje IKRTK-së në zbatim të ligjit penal dhe ligjit procedural penal.
3. Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e kësaj marrëveshje angazhohet për bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë ndërinstitucionale me Policinë e Shtetit në MB dhe IKRTK në MK, me synim rritjen e efijencës në kryerjen e hetimeve dhe rritjen e efektivitetit në goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë, si dhe administrimin e objekteve të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore të sekuestruar dhe/ose të konfiskuar sipas ligjit.

Neni 6

Dokumentacioni i transferimit/ekspertimit të objekteve

1. Palët bien dakord që, për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, dokumentacioni është si vijon:
 - a) Procesverbale dhe vendime sekuestrimi, vendime ekspertimi/vlerësimi të provave materiale (objekte të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore) të prokurorisë së rretheve gjyqësore kompetente ose policisë gjyqësore përkatëse;
 - b) Urdhëri i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin dhe kategorizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore;
 - c) Vendime gjyqësore në rastet kur vendimi i ekspertimit/vlerësimit të provave materiale (objekte të dyshuara pasuri trashëgimi kulturore) kërkohet nga gjykata kompetente;
 - ç) Raporte zyrtare të grupeve të punës ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, mbi vlerësimin dhe kategorizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, nëse ka;
 - d) Çdo dokumentacion tjetër i gjeneruar nga palët nënshkruese të kësaj marrëveshje apo i administruar prej tyre.

Neni 7

Shpenzimet financiare

Shpenzimet e mundshme të lidhura ngushtësisht me kryerjen e procedurave të magazinimit dhe ruajtjes së objekteve, sipas kësaj marrëveshje, përballohen nga Ministria e Kulturës dhe/ose institucioni i saj i varësisë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Neni 8

Shkëmbimi i informacionit

1. Palët bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse dhe në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje, angazhohen për komunikim të shpejtë e efektiv dhe shkëmbejnë informacione në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së objekteve pasuri trashëgimi kulturore të vjedhura dhe/ose të trafikuar. Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve midis palëve do të bëhet me mjete të sigurta komunikimi për të ruajtur konfidencialitetin e tyre dhe sekretin hetimor.

2. IKRTK-ja në MK sipas rastit, kur kryen ekspertimin dhe/ose vlerësimin e objektit të dyshuar pasuri trashëgimi kulturore dërgon menjëherë aktet e ekspertimit/raportet palës përkatëse.

Neni 9

Trajnimi dhe bashkëpunimi

1. Palët angazhohen të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë të ndërsjelltë, në interes të rritjes së efektivitetit në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e plotë të veprimtarisë kriminale në mbrojtje të objekteve pasuri trashëgimi kulturore të vjedhura dhe/ose të trafikuar, si dhe mënyrën e administrimit të tyre.

2. Zyrat përkatëse në PP e prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në MB në bashkëpunim me IKRTK, hartojnë, organizojnë dhe drejojnë programe kualifikimi dhe shpërndarjen e praktikave të mira për forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve, policisë gjyqësore dhe/ose prokurorëve në funksion të rritjes së efektivitetit për zbulimin dhe goditjen në kohë ndaj të gjitha formave të shfaqjes së objekteve pasuri trashëgimi kulturore të vjedhura dhe/ose të trafikuar.

Neni 10

Personat e kontaktit

1. Palët caktojnë dhe i komunikojnë njëra-tjetrës personat e kontakti në nivel qendror, për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit midis tyre.

2. Palët organizojnë takime të përbashkëta me kërkesë të secilës prej tyre sipas dinamikës, por jo me pak se një herë në gjashtë muaj, për qëllime të analizave të përbashkëta, në funksion të arritjes së rezultateve të duhura në luftën kundër të gjitha formave të shfaqjes së objekteve pasuri trashëgimi kulturore të vjedhura dhe/ose të trafikuar.

Neni 11

Ruajtja e sekretit dhe konfidencialitetit

1. Palët marrin përsipër të ruajnë sekretin hetimor, të dhënat personale dhe konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë nga pala tjetër, edhe pasi kjo Marrëveshje të ketë përfunduar.
2. Palët marrin përsipër që të gjitha informacionet e marra në zbatim të kësaj Marrëveshjeje të jenë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për sigurinë, sekretin hetimor të dhënat personale dhe konfidencialitetin.

Neni 12

Afati, përfundimi dhe zgjidhja e marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Afati i marrëveshjes mund të zgjatet për një afat të pacaktuar nëpërmjet konfirmimit me shkrim nga secila palë.
3. Mosmarrëveshjet lidhur me dispozitat e kësaj marrëveshjeje zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje origjinale ku Palët mbajnë secila nga 2(dy) kopje.

MINISTRI I KULTURËS

ELVA MARGARITI



MINISTRI I BRENDSHËM

BLEDAR ÇUÇI



PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

